



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRI I FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT

Nr Prot.

Tirane, me

2008

U R D H E R

Nr 65 Datë 5.5.2008

**PËR SHPALLJEN DHE ZBATIMIN E DETYRUESHËM TË
STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË
RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE.**

Ne mbështetje te nenit 4 te Ligjit nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" te ndryshuar ne Ligjin nr. 9477 datë 09.02.2006, në vendimin nr. 1 datë 19.04.2008 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dërguar me shkresën nr. 45 datë 25.04.2008;

URDHEROJ :

1. Shpalljen e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Raportimit Financiar (SNRF), të përkthyer në gjuhën shqipe nga Kompania angleze IMCL, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, sipas materialeve përkatëse ngjitur.
2. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar bëhen të detyrueshme për zbatim në datën 1 Janar 2008.
3. Për zbatimin sa më të mirë të tyre, me përdoruesit e standardeve, të organizohen seminare dhe trajnime të vazhdueshme, nga të gjitha palët e interesit.
4. Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar të publikohen në faqen e Internetit të Ministrisë së Financave dhe të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.
5. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të organizojë punën për botimin dhe përditësimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrveshja e lidhur për këtë qëllim, midis Ministrisë së Financave të Shqipërisë dhe Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) në Londër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 01 Janar 2008

Ridvan BODE

MINISTER